



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E KULTURËS

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. Prot 4631
Tiranë më 5.10.2020

Nr. Prot 2774
Tiranë, më 05.10.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

MINISTRISË SË KULTURËS DHE AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Ministria e Kulturës (MK) i përfaqësuar nga Ministri, Zj. Elva MARGARITI
dhe

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i përfaqësuar nga Kryetari Z. Gentian SALA,

Të angazhuar për promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe krijimit të hapësirave mbështetëse, për ruajtjen e krijimtarisë artistike, si dhe për të promovuar artin e kulturën në fushën audiovizive,

AMA si anëtar me të drejta të plota në Observatorin Evropian Audiovizual, organizëm që mbulon aktivitetet e kinemasë, monitoron tregun kinematografik brenda Bashkimit Evropian si dhe vendeve që synojnë anëtarësimin në BE,

Me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin në drejtime konkrete, bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë Marrëveshja).

Neni 1

Objekti


Objekti i kësaj marrëveshje bashkëpunimi kuadër është përcaktimi i fushave dhe i formave të tjera të bashkëpunimit ndërmjet palëve për rritjen dhe promovimin e artit, kulturës dhe muzikës, forcimin e identitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore, veçanërisht në fushën audiovizive.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi sipas fushës së kompetencave, bashkëpunim i cili do të fokusohet në sa më poshtë:

- a) shkëmbimin e të dhënave dhe analizave që burojnë prej bashkëpunimit dhe anëtarësisë në Observatorin European Audiovizual;
- b) angazhimin e përbashkët për çështje të prodhimeve audiovizuale duke pasur në fokus edukimin mediatik lidhur me artin dhe kulturën në media;
- c) shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues sa herë që ndërthuren fushat e kompetencës;
- d) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që i shërbejnë promovimit të kulturës kombëtare, mirëmbajtjes, zhvillimit, ruajtjes dhe dixhitalizimit të fondit të prodhimeve filmike shqiptare;
- e) shkëmbimin e informacionit/statistika për çështje me interes të ndërsjellë;
- f) inkurajimin e organizimit, mbështetjes dhe promovimit dhe kërkimit shkencor në lidhje me kulturën dhe artin në median audiovizive.
- g) bashkëpunimin për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit, si dhe parandalimin e piraterisë.



2. Palët mund të ndryshojnë në çdo kohë fushën e bashkëpunimit, nëpërmjet ndryshimit të marrëveshjes.
3. Secila prej palëve do të emërojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, sipas fushave të angazhimit që përcaktohen nga kjo marrëveshje.

Neni 3

Përdorimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshje do ta përdorë informacionin e marrë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, sipas fushës së kompetencës, dhe/ose sipas qëllimeve të përcaktuara në kërkesë.
2. Veprimet nga palët nënshkruese sipas kësaj marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo palë e kësaj marrëveshjeje duhet të ruajë informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë palë të tretë informacionin që kanë marrë sipas kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.

Neni 4

Takime të përbashkëta

1. Çdo 6 muaj titullarët e të dy institucioneve do të zhvillojnë takime për të diskutuar ecurinë e implementimit të kësaj marrëveshjeje.
2. Me iniciativën e secilës palë, takimet mund të bëhen në çdo kohë edhe me nivelet hierarkike të ndryshme përveç titullarëve.

Neni 5

Koordinimi midis palëve

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshjeje do të caktojnë nga një person kontakti.

2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore/elektronike.

4. Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

5. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:

Për MK-n	Drejtori i Kabinetit;
Për AMA-n	Këshilltari i Kryetarit.

Neni 7

Përmirësimet dhe ndryshime

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e palëve të kësaj Marrëveshje, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 8



Afati i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin



nga kjo marrëveshje.

2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.
3. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale/me vlerë të njëjtë, dy prej të cilave depozitohen pranë Ministrisë së Kulturës dhe dy të tjera pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Palët lexojnë, kuptojnë, pranojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, duke pranuar kështu kushtet saj,

PËR
MINISTRINË E KULTURËS



PËR
AUTORITETIN E MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

